

TEDA TIRANË SH.P.K.

**FTESË PËR NEGOCIATË PËR AGJENCITË E SPECIALIZUARA / ORGANET E
MEDIAVE VIZIVE**

Shoqëria TEDA Tirana, në mbështetje të nenit 7 pika 1/b, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM-së Nr.1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve ose reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore” ka parashikuar të realizojë procedurën me objekt:

“Promovimi i TEDA Tirana në rrjetet sociale dhe Website, duke përfshirë krijimin e videove promovuese dhe reels me elementë animimi, zhvillimin e përmbajtjes (content) dhe menaxhimin e fushatave ADS.”.

I- Qëllimi i shërbimit:

Realizimi i një fushate promovuese deri në fund të vitit 2026 për rritjen e vizibilitetit dhe prezencës së TEDA Tirana në mediat digjitale, përmes strategjive të përmbajtjes, reklamave të targetuara dhe optimizimit të vazhdueshëm të platformave online.

II - Arsyeja e nevojës për shërbimin:

Zhvillimi i kësaj fushate promovuese me fokus te reklamat me pagesë (ADS) është thelbësor për të rritur prezencën dhe vizibilitetin e TEDA Tirana në kanalet digjitale, duke siguruar që mesazhet për avantazhet e Zonës së Lirë Ekonomike të arrijnë audiencën strategjike brenda dhe jashtë Shqipërisë, përfshirë investitorë dhe partnerë potencialë. Përmes këtij angazhimi të strukturuar, TEDA Tirana synon të forcojë imazhin e saj profesional, të nxjerrë në pah shërbimet dhe lehtësitë që ofron për bizneset, dhe të krijojë një lidhje më të afërt dhe të qëndrueshme me audiencat e synuara. Përdorimi i fushatave ADS e bën të mundur që përmbajtja digjitale e krijuar të ketë ndikim të matshëm, duke rritur ndërveprimin, angazhimin dhe shikueshmërinë në rrjetet sociale dhe në website. Si rezultat, kjo fushatë pritet të përkthehet në vizita konkrete në faqen e internetit, rritje të ndjekësve dhe kontaktet direkte me investitorët, duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjike të TEDA Tirana për promovimin e investimeve dhe zhvillimin e zonës.

III- Periudha e kryerje së shërbimeve: 7 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Shërbimet e kërkuara do të kryhen sipas kërkesës së TEDA Tirana sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Termat e Referencës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

IV - Fondi limit i përcaktuar: 2,133,333 lekë pa TVSH.

V- Afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave: 04.06.2026, ora 12:00.

Vendi: Zyrat e TEDA Tiranë sh.p.k., Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Kontakt, Objekti Lyra 1, Njësia e Shërbimit 2014, Tiranë.

VI- Forma e paraqitjes së ofertave:

Ofertat të paraqiten në zarf jo transparent, të firmosur dhe vulosur, me shënimin:

Në emër të Komisionit të ngritur për ndjekjen e procedurave me objekt: “Promovimi i TEDA Tirana në rrjetet sociale dhe Website, duke përfshirë krijimin e videove promovuese dhe reels me elementë animimi, zhvillimin e përmbajtjes (content) dhe menaxhimin e fushatave ADS”

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pa hapura.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Gjuha për hartimin e ofertave është: **Shqip**

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, si përfaqësues ose persona të autorizuar.

VII - KRITERET E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

Çmimi më i ulët i ofruar	50 pikë
Përvoja të mëparshme dhe kualifikimet e stafit kryesor të propozuar	30 pikë
Metodologjia e Propozuar	20 pikë

VIII – TERMAT E REFERENCËS

Përshkrimi i shërbimeve të kerkuara:

1. Planifikimi dhe krijimi i përmbajtjes

- Hartimi i kalendarëve mujorë të përmbajtjes për 7 muaj. Kalendarit të muajit të parë duhet të hartohet brenda 5 diteve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Kërkim dhe planifikim përmbajtjeje (trende, konkurrentë, analiza të audiencës).
- Copywriting në përputhje me tonin e markës.
- Planifikimi dhe publikimi i përmbajtjes.

2. Prodhimi i postimeve dhe videove

2.1 12 postime mujore sipas kalendarit (statike, carousels, reels, stories), nga të cilat mesatarisht 8 video dhe 4 materiale të tjera.

8 videot do të përfshijnë 1 video profesionale që do të realizohet me stafin (intervista), animacione, të cilat do të kenë si qëllim shpërndarjen e informacionit rreth “TEDA Tirana” dhe pjesë nga aktivitetet.

2.2 Videot profesionale me tekst dhe elementë animimi për platformat digjitale:

2.2.1 Video me koncept kreativ (1 video)

Realizimi/prodhimi i 1 (një) video-je promociionale të konceptuar mbi storytelling, e cila ndërthur xhirime reale me personazhe dhe elemente të animacionit grafik. Qëllimi kryesor i kësaj videoje është krijimi i një personazhi të animuar, të ndërtuar mbi ikonën e logos së TEDA Tirana, i cili do të shërbejë si element identifikues i brandit. Ky personazh do të zhvillohet në vazhdimësi edhe në materialet e ardhshme video, me synimin që publiku ta njohë dhe ta lidhë menjëherë me imazhin e TEDA Tirana.

Afati i realizimit: Brenda datës 20 Nëntor 2026.

2.2.2 Video prezantuese institucionale (1 video)

Rikonceptim dhe realizimi/prodhimi i një videoje kryesore prezantuese, e cila do të përdoret si material bazë promovimi në evente të ndryshme, e cila do të përfshijë xhirime, grafika, video ilustruese.

Afati i realizimit: Brenda 15 diteve nga data e nënshkrimit të kontratës.

2.2.3 Video intervista (7 video)

Realizimi/prodhimi i 7 (shtate) video në formë intervistash informative me stafin, të cilat mund të përfshijnë: Infrastrukturën, lokacionin, Procedurat, avantazhet e investimit, klientët / partnerët (kur është e mundur) Me fokus në përvojën, avantazhet dhe besueshmërinë. Të gjitha shpenzimet logjistike (transporti/karburanti etj.) për realizimin e videove në vendodhjet që do të kerkohen janë të përfshira në ofertën ekonomike që do të paraqitet.

Afati i realizimit: Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimi i tyre do të bëhet nga 1 (një) video për çdo muaj.

2.2.4 Video festive (fundvit) – 1 video

Realizimi/prodhimi i 1 (një) videoje tematike për fundvitin, me qasje kreative dhe institucionale.

Afati i realizimit: Brenda datës 20 Dhjetor 2026.

2.2.5 Video për promovimin e platformes, webit - 1 video

Kjo video synon të promovojë përdorimin e internetit si burimi kryesor për marrjen e informacionit të saktë dhe të shpejtë mbi TEDA Tirana.

- Krijimi i imazheve grafike që pasqyrojnë avantazhet e investimit.
- Copywriting profesional për çdo video.

Afati i realizimit: Brenda datës 30 Qershor 2026.

3. Menaxhimi dhe interaktiviteti

- Publikim i postimeve mujore (organike dhe me pagesë) në Facebook, Instagram, LinkedIn dhe Google.
- Monitorim i komenteve dhe mesazheve.

- Ndërveprim me komunitetin (pëlqime, përgjigje, shpërndarje).
- Rritje e angazhimit përmes sondazheve, pyetje & përgjigje, stickers interaktive.
- Menaxhimi i fushatave ADS për targetimin e audiencave brenda dhe jashtë Shqipërisë.

4. Blogje dhe krijim përmbajtjeje

- 8 artikuj të optimizuar gjatë gjithë periudhës së kontratës për publikim ne web dhe platformat e tjera.
- Kërkim, shkrim dhe publikim i përmbajtjes.
- Hartimi i kalendarit të blogut dhe bashkëpunimi me ekipin për miratim.

7. Google Ads & Reklammat e targetuara

- Krijimi dhe menaxhimi i fushatave Google Ads dhe Meta Ads.
- Fushata retargetimi.
- Rishikim javor dhe optimizim.
- Buxheti mujor i parashikuar për ADS: maksimumi 450 EUR.

Shenim: Subjekti fitues duhet të paraqese dokumenta justifikues për shpenzimin e kryer (fatura/invoice etj). Teda Tirane do të paguaj për vlerën reale të shpenzuar dhe të provuar me dokumente justifikues.

8. Specifikimet teknike të Videove promovuese (spote)

- Kombinim i xhirimeve origjinale dhe elementeve grafike të animuar.
- Muzikë dhe narracion profesional me të drejta të sigurta.
- Formati teknik i videove duhet të jetë MPEG2 CBR35 ose H.264 CBR35.
- Për videon me koncept kreativ kërkohet format 16:9 (1920x1080 px).
- Të gjitha videot e tjera duhet të jenë në format 9:16 (1080x1920 px).
- Kohëzgjatja: jo më pak se 20 sekonda.

Detyrimet e operatorit ekonomik:

- Prezantimi i scriptit për secilin spot.
- Regjistrimi, pastrimi dhe montimi i zërit narrativ.
- Shoqërimi me muzikë dhe efekte audio.
- Renderizim i videove në formatin final dhe dorëzim në DVD.

(**Shënim:** në çmimin e ofertës përfshihet dhe pagesa për postimet në Facebook, Instagram, LinkedIn dhe Google, sipat kërkesave në Termat e Referencës)

VIII- KËRKESAT PËR KUALIFIKIM DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQITET NGA OFERTUESIT

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1.

1. Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të deshmojë kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate dhe/ose faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. CV e operatorit ekonomik - një përshkrim i përgjithshëm i profilit të veprimtarisë, të dhëna të përgjithshme lidhur me eksperiencat dhe bashkëpunime në përmbushje të projekteve të ndryshme me natyrë shërbimi në fushën objekt të kësaj procedure.

3. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon të punësuar apo me kontratë angazhimi (në rastin që angazhon freelancer) staf të aftë për kryerjen e shërbimeve objekt të kësaj procedure, si vijon:

1 (një) Menaxher i Mediave Sociale + Specialist i ADS

- a. Të ketë minimumi 3 vite eksperiencë pune
- b. Të zotërojë gjuhën angleze

1 (një) Copywriter + SEO Content Writer

- a. Të ketë minimumi 3 vite eksperiencë pune
- b. Të zotërojë gjuhën angleze

1 (një) Videograf

- a. Të ketë minimumi 3 vite eksperiencë pune në xhirime për advertising
- b. Të zotërojë gjuhën angleze

1 (një) Dizajner grafik + Motion Designer

- a. Të ketë minimumi 3 vite eksperiencë pune
- b. Të zotërojë gjuhën angleze
- c. Të ketë aftësi në After Effects / Canva Pro / Premiere.

Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike operatorët të paraqesin dokumentacionin: *Diplomë, Librezë pune, CV, si dhe deshmi kualifikimi/ specializimi, licensa/certificata profesionale/ leter referenca, ose çdo lloj dokumenti tjetër ekuivalent që vërteton përmushjen e kritereve të kërkuara si me sipër.*

4. Stafi i angazhuar duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti ku te shprehet angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit per kete objekt procedure (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese).

5. Për plotësimin e kriterit të “**Metodologjia e Propozuar**”, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë ku të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, si dhe duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e kësaj metodologjie me përfaqshjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës. Metodologjia e propozuar duhet te permbajë të paktën fushat e mëposhtme:

- a. Strategjia e punës 7-mujore: si do strukturohet puna në secilin muaj.
- b. Procesi i krijimit të përmbajtjes (nga ideja, tek miratimi e publikimi).
- c. Metodologjia e prodhimit të videove (xhirimi, montazhi, dorëzimi).
- d. Plani i menaxhimit të rrjeteve sociale (postime, ndërveprim, monitorim).
- e. Mjetet dhe programet që do përdoren (Adobe Suite, Meta Business, Google Ads Manager, etj.).

6. Ofertuesi duhet te paraqese nje deklarate ku deklarone se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

8. Ofertuesit duhet të paraqesë një deklaratë ku deklaron se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në Ftesen për Negociata, si dhe marrin përsipër të realizojmë shërbimet e kerkuara brenda afateve të percaktuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Këtë ftesë për negociata mund ta gjeni edhe në faqen e TEDA Tirana, në adresën www.teda.al

Ne jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociata.

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Data:

Për: **TEDA Tirana**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in**]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Fteses per Negociata të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës të publikuar në www.teda.tirana.al]*.
- (b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*), nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës të publikuar në www.teda.tirana.al*].
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për TEDA TIRANA, në përputhje me Ftesen per Negociata (shih më poshtë), [*vendos objektin e procedurës të publikuar në www.teda.tirana.al*] shërbimet e kerkuara Termat e References.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Ftesen per Negociata;
 2. Kriteret e Përzgjedhjes;
 3. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	